

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2017”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit është miratimi i buxhetit faktik të qeverisjes së përgjithshme të vitit 2017.

Objektivi që synohet është plotësimi i kërkesës ligjore (të neneve 62 dhe 63, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”), për raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2017, të llogarive vjetore për transaksionet financiare të entiteteve të qeverisjes së përgjithshme (qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe të trajtimit të pronave) dhe informimin për arritjen e objektivave, situatën e menaxhimit, të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është i lidhur me prioritetet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: “Sektor publik i besueshëm, eficient dhe transparent”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Publikimi i informacionit të plotë mbi performancën makrofiskale dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2017, objektivat e arritur dhe produktet e realizuara nga çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62 dhe 63, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Lidhja me prioritetet e BE-së: “*Rule of law*”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban nenin 1 “Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit”, përmes të cilit miratohet raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit për vitin 2017, sipas dokumenteve të mëposhtme, pjesë përbërëse të tij, si më poshtë vijon:

- a) Pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, për vitin 2017;
- b) Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2017, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuara;
- c) Raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2017;
- ç) Raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës, për vitin 2017;
- d) Raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2017.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektligjit kanë kontribuar strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të njësive të qeverisjes së përgjithshme.

VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij projektligji.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me të ardhura apo shpenzime buxhetore.

KËSHILLI I MINISTRAVE